REPUBLIKA E SHQIPËRISË

# KËSHILLI I BASENIT UJOR SEMAN

ZYRA E ADMINISTRIMIT TE BASENIT UJOR SHKUMBIN-SEMAN
Nr. 626 Prot.
Datë,më 06.11.2024

## VENDIM

**Nr.12, datë 30.10.2024**

**PËR**

## MIRATIMIN E LEJES "PËR PËRDORIM TË BURMIT UJOR SIPËRFAQËSOR PËR PRODHIM HIDROENERGJETIK SUBJEKTI "F.Z CONSTRUCTION" SH.P.K

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, "*Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre*", me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman.

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e lejes për përdorim burimi ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjetik subjekti "F.Z Construction", sipas Kontratës me Nr. 10 Rep., Nr. 08 Kol.,datë 08.01.2019 "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit "FZ Hydropower"", me kapacitet prodhues 2 MW, në ujërat e kanalit të Gostimës, me vepër marrje në lumin Devoll, Bashkia Cërrik, Qarku Elbasan.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

**HEC FZ Hydropower**

Vendndodhja e veprës së marrjes 1/ burimi ujor Lumi Devoll

- X= 504713.47; Y= 4537316.45.48; Z=96.3 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja llogaritëse: 22.5 $m^3/s$

- Prurja mesatare vjetore: 43.6 $m^3/s$
- Prurja ekologjike: 6.45 $m^3/s$

Vendndodhja e godinës së Centralit

- X= 499790.42; Y= 4538895.85; Z=76.5 m.m.n.d. (KRGJSH)
- Prurja që shkarkohet: 22.5 $m^3/s$
- Prodhimi vjetor i parashikuar: 12.856.000 kwh/vit
- Fuqia e instaluar: 2000 kwh
- Vlera totale e investimit: 495,5001,305 lekë me TVSH.

Për përdorimin e këtij burimi ujor duhet të plotësohen kushtet e mëposhme:

- Të mos cënoj fumizimin me ujë të popullatës dhe të industrisë për nevojat e tanishme dhe të prespektivës në sasinë 70 1/sek për nevojat e pushtetit lokal Bashkisë Cërrik.
- Të zbatoj grafikun për vaditje në kohë (ditë) dhe në sasi (1/s) për çdo vite të hartuara nga Bordet e Kullimit të pushtetit vendore dhe atë Qëndrore.nga 1 Maj deri në 30 Shtator në sasinë 8.5 $m^3$/sek të pushtetit lokal Bashkisë Cërrik dhe të mos cënohet fuksionaliteti i kanalit Benjë-Shkumbin në sasine prej 20 $m^3$/sek që nevoiten për sezonin e vaditjes për furnizimin e kanalit Peqin -Kavajë.
- Të respektoj grafikun e vaditjes edhe jashtë periudhës, kur e kërkon Bordi i Kullim it.

3. Zbatimi i kontratës nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.
4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit te subjektit te interesuar.

**KRYETARI I KBU SEMAN**

**MBARIME ISUFAJ**